Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0401

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) HARST Group SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E PEJES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i palestres në Zahaq RITENDER me numër të prokurimit 635-23-3456-5-1-1, me 13/09/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“HARST Group”SH.P.K. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me dt, 16.06.2023 (me numër protokolli 401/23) për aktivitetin e prokurimit me titull:“ Ndertimi i palestrës ne Zahaq RITENDER“ me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejes.

2. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

3.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 07.04.2023Komuna e Pejesnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i palestrës ne Zahaq RITENDER” me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1". Nderkaq me datën 02.06.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “HARST Group”sh.p.k. me datën 07.06.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 08.06.2023, AK- Kuvendi Komunal Peje me vendim ka refuzuar si te pabazuar kërkesën per rishqyrtim te OE.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE“HARST”SH.P.K. ankues me datën 16.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 401/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 10.07.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e Grupit të OE“HARST”SH.P.K.**Të aprovohet si e bazuar**, dhe rekomandon qe**Të anulohet** njoftimi dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Në ketë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;

b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;

c. vlera e parashikuar e kontratës: 858.509.50 € vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues (në përbërje kolegjiale) administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Pohimet ankimore të OE "HARST Group"sh.p.k.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) OE ka ofruar planin dinamik 150 ditë pune ndërsa është dashtur të ofrohet 150 ditë kalendarike. OE ankues pretendnon se një arsyetim i tillë nuk qëndron, dhe se të njëjtit nga data e fillimit deri në përfundim kanë prashikuar planin dinamik prej 150 ditëve. Eksperti shqyrtues pas analizitmit të pretendimeve ankimore, arsyetimit të AK-së dhe ofertës së OE aniues, ka gjetur se i njëjti në planin dinamik në total ka 150 ditë. I njëjti plan dinamik sipas tabelës së plotësuar nga OE pavarsisht shprehjes së përdorur nga OE para fillimit të tabelës "150 ditë pune", I njëjti plan nuk parasheh ditë shtesë apo ditë "jo pune". po ashtu edhe në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, është plotësuar në mëyrë të njëjt, dmth duke mos parashikuar ditë "jo pune" dhe në total ka 150 ditë, njëjt si OE ankues. Përveq kësaj në kërkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë sin ë vijim "Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës:**minimim 150 dit deri ne max 250 dit kalendarike".** Përveq kësaj kijo dëshmohet edhe përmes deklaratës së aneksi 7 deklarata e OE për afatin e implementimit të projektit dhe periudhën garantuese, ku decidivsht shënon afati i implementimit të këtij projekti është 150 ditë nga data e fillimit të punëve dhe 6 vite (maksimumi i mundshëm) periudha garantuese. Bazuar në gjitha këto sipas ekspertit shqyrtues pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, Paneli mbështeti shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës andaj pohimi ankimor në ketë rast konsiderohet i bazuar.

Ankuesi, po ashtu, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK)se OE ka ofruar certifikatë ISO 3834-2005 ndërsa është dashtë të ofrohet ISO 3834-2006, ku po ashtu sipas AK-së këtë kërkesë duhet ta plotësojnë të gjithë anëtarët e grupit veq e veq. Eksperti shqyrtues ka sqaruar se ISO 3834-2006 është standard për "Saldim me shkrirje i metaleve" dhe si e tillë vlerësojmë se është kërkesë e kapacitetit Teknik/profesional e cila edhe në dosje të tenderit është vendosur tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, dhe si e tillë kjo kërkesë duhet aplikuar ndaj grupit si tërësi dhe jo të plotësohet nga secili anëtar veç e veç siç pretendon AK. Në rastin konkret lideri grupit ka ofruar certifikatën ISO 3834-2005 (identike me ISO 3834-2006), ndërsa dy anëtarët e tjerë kanë ofruar certifikatën për saldim sipas ISO 3834-2006 ashtu si është kërkuar nga AK. Në rastin konkret ka mjaftuar që vetëm një anëtar i grupit të ofroj certifikatën në fjalë që të plotësohet kërkesa e AK-së. Bazuar në gjitha këto sipas ekspertit shqyrtues pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e nenit 71 par.4 lidhur me nenin 69 të LPP-së. Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, se lideri "*lideri grupit ka ofruar certifikatën ISO 3834-2005 (identike me ISO 3834-2006), ndërsa dy anëtarët e tjerë kanë ofruar certifikatën për saldim sipas ISO 3834-2006 ashtu si është kërkuar nga AK*", Paneli shqyrtues pretendimin ankimore e klasifikon si të bazuar duke u mbështetur në këtë hulumtim të ekspertit shqyrtues sa i përket kësaj çertifikate se është identike dhe konform me Dosjen e Tenderit.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) se OE nuk plotëson kërkesën për "Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite përvojë pas diplomimit. I certifikuar për efiçience te energjisë.". Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE ankues ka gjetur se për këtë kërkesë përveç personave te kontestuar nga AK, OE ka ofruar dëshmi për z. Shabani i cili plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu edhe z.Nitaj ka ofruar dëshmitë në pajtim me kërkesat e dosjes Dmth. Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës dhe certifikatën për efiqencë. AK po ashtu ka mund që në pajtim me nenin 72 të kërkoj sqarime shtesë për personat e kontestuar që janë marr si arsye për eliminim, kështu që për ekspertin shqyrtues pretendimin ankimor i bazuar dhe se OE plotëson kërkesat e dosjes së tenderit për Inxhinier i Diplomuar elektroteknik i certifikuar për efiqencë. Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, mendon se zgjidhja më e mirë do të ishte që AK me qëllim të mos diskriminimit apo pabarazisë të kërkoj informacione shtesë konform nenit 72 të LPP, nëse është e nevojshme edhe nga institucionet universitare sa i përket inxhinerëve se a i plotësojnë ndonjëri kushtet e Dosjes së Tenderit.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i eliminuar të tij/sajë se (sipas AK) se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për Eskavator (skip), "*keni paraqitur një dëshmi, marrëveshje, me OE"LG Construction Group SH.P.K", për paisjen Ngarkues me lugë, Marka: Fermec. Mirëpo kjo pajisje nuk është në listën e asnjërit nga OE*.". Vlerësimi i ekspertit shqyrtues është se pavarësisht faktik nëse OE nuk e ka shënuar në "listë" të pajisjeve pajisjen në fjalë, ofrimi i dëshmive/marrveshjes është provë bindëse dhe e pamohueshme se OE ka në dispozicion këtë pajisje. Po ashtu, OE ka ofrua dëshmi edhe për eskavator të tjerë që sipas mendimit tonë plotësojnë kërkesën e AK-së, kjo sepse termi "skip" nuk e definon asnjë pajisje as në gjuhë shqipe apo gjuhë të tjera. Për më tepër nëse hulumtohet në internet termi se 'skip" jep rezultate për kontejner të mbeturinave qka nuk ka të bëjë as me esakavator e as me ngarkues. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimorë është i bazuar. Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, Paneli duke u mbështetur në këtë hulumtim të ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e ekspertizës, pohimin ankimor në ketë rast e konsideron të bazuar.

Ankuesi po ashtu ka pohuar edhe klasifikimin apo renditjen duke pretenduar se duhet të jetë i renditur i pari sipas pikëve. Edhe pse eksperti shqyrtues këtë pretendim e ka klasifikuar si të bazuar, paneli shqyrtues nuk lëshohet në këtë pretendim për shkak se lënda kthehet në ri-vlerësim dhe në fazën e ri-vlerësimit fillimisht duhet të vërtetohet përgjegjshmëria e OE, pastaj të bëhet edhe kalkulimi i pikëve dhe renditjes sipas pikave.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë ofrimin e "kopjes së noterizuar" që nuk e plotëson kërkesën e AK-së për "kontartë të noterizuar". Sipas e ekspertit shqyrtues kërkesa e dosjes ka qenë që "kontrata e noterizuar" e jo kopja e noterizuar dhe dallimi esencial sipas mendimit të tij në mes këtyre dy dokumenteve është se noterizimi i kontratës kërkon vërtetimin e nënshkrimit të gjitha palëve në prani të noterit, me qka edhe formalizohet/solemnizohet dokumenti/kontrata, ndërsa vërtetimi i kopjes së një kontrate nuk kërkon vërtetimin e asnjë nënshkrimi të asnjë pale dhe nuk e formalizon/solemnizon dokumentin në fjalë. Megjithatë vlerësojmë se me rastin eventual të rivlerësimit AK mund të kërkoj informata/sqarime shtesë, nëse këta persona janë vërtetë punëtor të kompanisë përmes dëshmive

nga ATK, kontributeve të rregullta mujore dhe vjetore. Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, e mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues dhe konstaton se zgjidhja më e mirë do të ishte që AK me qëllim të mos diskriminimit apo pabarazisë të kërkoj informacione shtesë konform 59 dhe nenit 72 të LPP, nëse këta persona janë vërtetë punëtor të kompanisë përmes dëshmive nga ATK, kontributeve të rregullta mujore dhe vjetore.

Ankuesi, ka atakuar vendimin e AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se OE i rekomanduar për kontratë për z Hajdari, certifikatën e efiqencës nga SEEK ku trajnues ka qenë GFS Consulting nuk e plotëson kërkesën e AK-së për certifikim në efiqencë. Eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se certifikatat për efiqencë të energjisë në Kosovë lëshohen nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri pran Universiteti Hasan Prishtina së bashku me Ministrinë e Ekonomisë – Agjencia e Kosovës për Efiqencë të Energjisë dhe trajnimi zgjat për mbi 1 muaj, dhe përfshinë leksionet, auditimin në terren, përgaditjen e raportit të auditimit të energjisë dhe provimin bazuar standardin DIN EN 16247 për efiqencë të energjisë, ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar certifikatë të një kursi dy ditorë të lëshuar nga SEEK dhe kursi është mbajtur nga GFA Consulting Grup, kështu që sipas mendimit të ekspertit është se certifikata e kursit dy ditor e mbajtur nga GFA consultin Group dhe e lëshuar nga SEEK nuk plotëson kërkesën Certifikim në Efiqencë të energjisë pasi një certifikim i tillë bëhet nga institucionet vendore përkatëse të për shkruara më lart. Paneli shqyrtues, këtë pretendim nuk mund ta konstatoj por duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, obligon AK që në fazën e ri-vlerësimit ta bëjë edhe këtë verifikim qoftë tek institucionet tjera rreth nxjerrjes së kësaj çertifikate dhe AK ta vlerëson përfundimisht se OE në fjalë a i ka ofruar dëshmitë konform kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Prandaj, Paneli shqyrtues në bazë të shpjegimeve të ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe duke u bazuar në dizpozita ligjore, se AK duhet ta ketë parasysh se vlerësimi i ofertave duhet të bëhet konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 59 të LPP, i cili në paragrafin 4, citon: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*", si dhe konform nenit 56 të LPP, i cili në paragrafin 3, citon: "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*." e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59 dhe 72 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të

cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **HARST Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: